

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Innovex healthcare Distribution” shpk

KREUI

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezigjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte: “**Innovex healthcare Distribution**” shpk.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria “**Innovex healthcare Distribution**” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (ketu e ne vijim referuar “Shoqeria”). Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Ajo do te ushtroje aktivitetin e saj ne Republiken e Shqiperise ne baze te regjistrimit ne institucionet tatimore dhe ne regjistrat tregtarshqiptare, si dhe jashte saj ne baze te modaliteteve ligjore qe kerkohet nga shteti ku do te ushtroje veprimtarine.

Shnderimi i saj ne nje forem tjeter dote behet sipas dispozitave te ketij statuti dhe ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregetarët dhe Shoqerite Tregetare”.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka Seline ne Rruga Tefta Tashko. Pall Alb-Building shpk, njesi sherbimi nr. 1, kati pare Tirane

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Farmacii. Import – Eksport, shitje me shumice dhe pakice te suplementeve. Tregeti online. Transporte te ndryshme. Tregti, import – eksport, furnizime, instalime dhe mirembajtje e pajisjeve elektronike te aparaturave teknike te telekomunikacionit.

Neni 5

Kohezigjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000leke dhe eshte i ndare ne 1 kuote. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortaku i shoqerise perkatesisht:

Kejdi Jazexhiu kuota me vlere te pergjithsme 100.000 Leke, qe perbejne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet e zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille, te pakten 45 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese te thirrur per te marre vendim rreth ketij projekti.

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti, e ben te detyrueshem marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren minimale.

Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forme tjeter.

Ne rast moszbatimi te kerkesave te ketij paragrafi, cdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise.

Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transerimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.

Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vleren e percaktuar sipas rregullave te nenit 11 te ketij ligji.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

KREU III **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve branda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratoret.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve, ne rast se ortaket miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ortaket lajmerohen me leter rekomande te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njohtohet rendi i dites.

Lajmerimi behet nga administratori ose, ne mungese te tij, nga ekspert kontabel i autorizuar, po qe se ka te tille. Secili ortak mund te kerkoje ligjerisht caktimin e nje mandatmbajtesi te ngarkuar per thirrjen e asamblese dhe caktimin e rendit te dites.

Cdo mbledhje e asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet.

Megjithate anulimi nuk ka vlere, ne rast se ortaket jane te pranishem ose te perfaqesuar.

Secili ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Secili ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter.

Ai mund te perfaqesohet edhe nga nje tjeter person.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administrator do te jete **Kejdi Jazexhiu me nr ID J60606079A**

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleje qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose sebashku, kane te dretje te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkatuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Ortaku qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne cdo kohe te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratoret.
Mbledhja e Asamblese se Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendeve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, sic edhe parashikohet nga ligji, ne raport me kuotat e zoteruara nga secili prej ortakeve.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetore dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se Ortakeve.
Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te ortakeve, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshe te shoqerise dhe garantimin veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante, krijimin e Rezerves Ligjore. Rezerva Ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5% te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Neni 18

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 19

Prishja dhe likudimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar sic mund te jene:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshe te veprimtarise se saj.

b) Ne nje nga menytrat e parashikuar nga ligji “Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare”.

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria me ane te bashkimit, mund t’i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t’i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

Ortaket e shoqerise, qe bejne kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfitojne pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompensim me para, vlere e te cilit nuk mund te kaloje 10 % te vleres nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena.

Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa lukuidim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerite perfituese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerive qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuar ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i miratimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parshikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne QKR.

Neni 22

Lukuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizike apo juridike vendas apo te huaj.

Neni 23

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te linde gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten ceshtja mund te behet objekt konflikti gjyqesor ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor TIRANE

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt-themelimi,statutin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Neni 25

Mosmarrveshjet

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij akt-themelimi, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues te shoqerise tregtare **“Innovex healthcare Distribution”** shpk, nenshkrhet ne Tirane sot me date 16/08/2022.

ORTAKU I VETEM

Kejdi Jazexhiu

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke, positioned below the name 'Kejdi Jazexhiu'.